

AKT THEMELIM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA
"VOKA" sh.p.k

Durres me 05.03.2018

Ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret Shoqerite Tregtare", Ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren kombetare te Rregjistrimit, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuara, me mertimin "VOKA" sh.p.k

KREU I

Neni 1

Emertimi

Shoqeria do te emerohet "VOKA" sh.p.k dhe eshte person juridik I te drejtes shqiptare. Znj. Gerta VOKA, atesia Faslli e datelindjes 27 Tetor 1984, lindur ne Luz I Madh Durres, Shtetesia Shqiptre, me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajes i leternjoftimit me nr. I46027060R.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitet juridik pasi te jete regjistruar ne Q.K.B, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj.

Shoqeria "VOKA" sh.p.k eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortakut i vetem, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Neni 3


Selia

Selia e shoqerise eshte adresa Durres L 17 rruga Faik Konica, banese private nr. 7163 Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje selin e tije, te hap zyre perfaqesimi, dege, te krijoj filiale, si brenda ashtu edhe jasht Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti veprimatrise

Import eksport dizenjim tregtim i mobiljeve, shtrim parketi, punime me veshje druri, arredime zyresh dhe ambjenteve te ndryshme etj. Tregti me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike, elektrike, elektronike, paisje hidrosanitare, etj. Prodhim materialesh ndertimi, pjese dhe makineri qe lidhen me to. Pjese kembimi, kancelari etj. Trasport i brendeshem dhe i jashtem per vete dhe per te trete etj. Zyre konsulence dhe kontabiliteti. Prodhim dhe shitje te energjise. Tregtim te materialeve te pastrimit higjenik dhe kimik, detergjente, etj. Tregtim te paisjeve speciale per policine, Sherbimi e rojeve civile. Punime ne fushen e ndertimit dhe rikonsrksioneve. Sherbime ne fushen e Pastrimit dhe



mirembajtjes se mbeturinave dhe te mbetjeve urbane, etj. Tregtimi i aparateve celular, kompjuterave fotokopje, servera, softuera, scanner, aksesore qe lidhen me to, tregtim te kartave te telefonit dhe servis per celular dhe pajisje elektronike. Tregtim i mallrave ushqimor, blegtoral, bujqesor, fruta perime etj. Montim çmontim te dekoreve festive, tregtim te fishekzjarreve, tregtim artikuj zbukurimi etj. Evadim te mbeturinave, kimikateve, lende te rrezikshme, etj. Tregtim prodhim i ujit etj. Punime ne Fushen e Ndertimit, Rruge, Shkolla, Ndertesa Civile, Pallate, Ujesjellsa, Gazesjellsa etj, Rikostruksione ne fushen e ndertimit ne Rruge, Ndertesa Civile, Pallate, Ujesjellsa, Gazesjellsa etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000. leke
Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise :

Znj, Gerta VOKA, zoteruesi 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 100,000. leke
qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise; Kapitali i shoqerise do te hidhet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise .

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:


- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë është znj, Gerta VOKA , atesia Faslli, e datelindjes 27 Tetore 1984, lindur në Luz i Madh Durres, shtetase Shqiptare madhore, me zotesi të plote juridike dhe për tevepruar, mbajtes i leternjoftimit të shtetit shqiptar me nr I46027060R, emeruar në këte detyre



per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.


Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare “VOKA” shpk nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale .

ORTAKU I VETEM

Gerta VOKA

